

Jehona RUSHIDI – REXHEPI
MODELE TË CITATSHMËRISË NË LETËRSINË SHQIPTARE PËR
FËMIJË

Abstrakti: Teoria e citatshmërisë domosdo paraqitet si e nevojshme në rastet kur tekstin letrar e shqyrtojmë nga sasia dhe mënyra e kontaminimit të tij. Nëse nisemi nga teoritë postmoderne, të cilat tekstin letrar e shohin si tekst që është vazhdim i një teksti, rishkrim apo kryqëzim sipërfaqesh tekstuale, letërsia shqiptare për fëmijë shihet si shembull i mirë për të shërbyer në ilustrimin e teknikave dhe modeleve të citatshmërisë. Punimi, përpara se të ndalet në ilustrimin e modeleve të citatshmërisë në letërsinë për fëmijë, do të shtrojë klasifikimet dhe modelet që i ofron vetë teoria. Konkretisht, do të sqarohen citatet intrasemiotike, intersemiotike, citatet e rrejshme, citatet e plota, të pjesëhme, etj. Përzgjedhja e shembujve do të merret nga letërsia bashkëkohore për fëmijë, por gjithashtu edhe nga faza të mëhershme duke pasur parasysh të përzgjidhen si shembuj ato krijime letrare që më së shumti qarkullojnë në tekstet shkollore për fëmijë të grupmoshave të ndryshme. Në këtë mënyrë, përmes shembujve do të mundësohet konkretizimi i klasifikimeve teorike të llojeve të citateve në letërsi. Punimi përbëhet kryesisht nga dy pjesë, ajo teorike dhe aplikative, ndërsa natyra e punimit është e tillë që do të shfrytëzojë njohuri nga teoria e intertekstualitetit, teoria e citatshmërisë dhe hermeneutika.

Fjalë kyçe: Teoria e citatshmërisë, klasifikime, modele catesh, letërsi për fëmijë.

Hyrje

Pikësynimi kryesor i punimit është ta nënvijëzojmë njërën nga format e manifestimit të intertekstualitetit, citatshmërinë. Në punim, duke u mbështetur në qëndrime teorike të njohura, do të jepet një pasqyrë e mendimit teorik lidhur me citatshmërinë dhe format e manifestimit të saj, lidhjet me intertekstualitetin dhe shembuj konkretë. Nënkuptohet që brenda një punimi nuk do të kalohet në detaje nga autori në autor, por në bazë të tipologjisë që do të ndiqet, do të orvatem i që të jepet nga një shembull për modelet (citatet) ekzistuese.

Për ta përcaktuar më saktësisht qëllimin, në punim do të tregohet se në çfarë formash paraqiten citatet në letërsi, si manifestohen ato në kuptimin e gjerë dhe të ngushtë të fjalës dhe çfarë raportesh dhe emërtimeve lindin nga ato lidhje. Ideja lindi nga vetë mungesa e trajtimit të teorisë së citatshmërisë në mendimin tonë kritik e teorik, sidomos kur flitet në aplikimin e trendeve në analizat letrare të cilat e anashkalojnë shpeshherë letërsinë për fëmijë. Duke e zbatuar këtë teori mundësohet të shqyrtohet hapja e tekstit, pozita e tekstit përballë mediave, arteve me të cilat komunikon, pozicionimi dhe marrjet e rimarrjet nga tekstet tjera. Shëtimi teorik do të mundësojë që të rilexojmë e rinjohim tekste e teknika.

Ajo që na shërben nga studimet paraprake, janë vështrimet që tregojnë mbështetjen e teksteve konkrete të letërsisë për fëmijë, pavarësisht se ato nuk mbështeten në teorinë e citatshmërisë apo intertekstualitetit. Ndihmesë janë studimet e Astrit Bishqemit dhe Bedri Dedjës, në të cilat do të referohemi më poshtë në punim dhe njëkohësisht studimet tjera të cilat e trajtojnë teorinë e intertekstualitetit dhe citatshmërinë si manifestim brenda saj, duke mundësuar që ta harmonizojmë mendimin ekzistues teorik, kritik, me gjetjet tona në letërsinë bashkëkohore shqiptare për fëmijë.

Metodat

Punimi do të mbështet mbi njohuritë nga teoria e citatshmërisë dhe teoria e intertekstualitetit. Për shkak të specifikës së citatshmërisë si manifestim, qasja e studimit do të jetë e brendshme dhe e jashtme. Pjesa e parë e punimit kryesisht do të mbështetet në shestim teorik të çështjes që më pas të kalohet në aplikimin mbi shembuj konkretë.

Citatshmëria në letërsi

Pikënisje për dhënien e pasqyrës së fenomenit të citatshmërisë do të jetë paraqitja e qartë e lidhjeve intertekstuale (që janë baza e citatshmërisë) në studimin “Teoria e citatshmërisë” të studiueses Dubravka Oraïç-Toliç (Oraïç-Toliç, 1990). Kjo studiuese, në vështrimin e saj lidhur me këtë çështje, niset nga Shkllovski duke sqaruar se citatshmërinë ky studiues e përdor në dy kuptime themelore, gjegjësisht aty citatshmëria shihet si rinjohje dhe si identifikim i tekstit të huaj brenda tekstit tonë.

Për t’u pozicionuar drejt një analize të kësaj natyre, është e logjikshme që të ikim nga konceptet autor-vepër dhe t’i qëndrojmë afër raportit vepër-tekst, duke e kuptuar tekstin si hapësirë ku ne i rinjohim shenjat, gjegjësisht teksti prodhohet në bazë të njohjes. Ky raport përkon edhe me konceptet e Rolan Bartit mbi vlerën e autorit, megjithatë si më praktike për realizimin e këtij punimi u panë klasifikimet në Teorinë e citatshmërisë (Oraïç-Toliç, 1990).

Duke u shoqëruar sqarimet me anë të ilustrimeve, kjo studiuese (Oraïç-Toliç, 1990) e jep qartë përkimin mes sipërfaqeve tekstuale. Nga sqarimet dhe ilustrimet vërehet që *ekskluzioni*, rastet kur A dhe B janë brenda hapësirës së njëjtë por nuk përputhen, jepen si shembull për *aluzionin*. Shembulli i dytë është *inkluzioni*, ku vërehet që sfera B është brenda sferës A, ku A-ja është më e gjerë. Këtu numërohen: *parodia*, *pastishi*, *travestia* dhe të ngjashme. Rasti i tretë është ai kur sfera A pritet me sferën B dhe këto raste realizohen te *reminishenca*, *toposi*, *jehona*, etj. Shembulli i katërt paraqet përputhjen e sferës A dhe B, ato tërësisht përputhen dhe këtu numërohen përthithimet apo citatet e pavetëdijshme.

Kështu, nga ajo që u tha më sipër, vlen të përmendet që shembulli i dytë, *inkluzioni*, shihet të jetë ajo që Bahtini e sheh si *ligjërim të dyfishtë*, ndërsa llojet tjera shihen si dialogizim në kuptimin më të gjerë të fjalës. Sidomos është mjaft i qartë shembulli i parë ku thuhet që te

aluzioni, lidhja intertekstuale realizohet nëpërmjet *sinjaleve negative (minus)* të cilat lexuesi i kthen në *sinjale pozitive (plus)*.

Në studimin e lartpërmendur (Oraç-Toliç, 1990), citatet dallohen edhe sipas *sinjaleve*, sasisë së përputhjes, llojit të nëntekstit, funksionit, etj. Kjo tipologji ofron një mundësi mjaft praktike të aplikimit të nocioneve. Ato mbulojnë më tepër kategori citatesh, p.sh: nëse merret parasysh shkalla e *sinjaleve*, dallohen citate të jashtme (të drejtpërdrejta), ose të brendshme (të mbuluara/shifruara) të cilat mund të dalin nga format më të thjeshta e deri te ato më radikale; sipas sasisë së përputhjes të klasifikojnë citate të tërësishme, të pjesshme dhe të zbrazëta (të rrejtshme); sipas llojit të nëntekstit dallohen ato intrasemiotike (që i përkasin të njëjti art) intersemiotike (i përkasin arteve të ndryshme), transsemiotike (mes artit dhe sferave tjera që nuk janë art), gjegjësisht dallohen citatet *letrare, autocitatet, metacitatet, citate intermediale* dhe ato *jashtëestetike*.

Pasqyrë e llojeve të citateve në letërsinë bashkëkohore shqiptare

Për ta kuptuar praninë e citateve, pavarësisht në cilin lloj të paraqitjes së tyre në letërsi, parim nisës duhet pasur idenë se çdo vepër është intertekst dhe se asnjë vepër nuk është krejtësisht e pastër dhe origjinale. Në traditën e studimeve tona, kohë pas kohe janë ilustruar qëndrime të ngjashme, por pa ndonjë lidhje konkrete mes citatshmërisë dhe letërsisë për fëmijë. Për ta qartësuar këtë, le të përsërisim se:

“Të thuash se s’ka ide të Borgesit që të mos ketë ekzistuar më parë, është njësoj si të thuash se s’ka asnjë notë të vetme të Bethovenit që s’ka qenë prodhuar më parë. Ajo që mbetet themelore të Borgesit, është aftësia e tij për të përdorur depozitimet më të ndryshme të enciklopedisë për të bërë muzikë të ideve” (Eko, 2007).

Për t’i hetuar lidhjet të cilat u sqaruan më sipër, u kuptua se rolin kryesor e ka lexuesi. Lexuesi dhe llojet e profilit të tij na orientojnë në konstatimin e studiueses Nathalie Piegay-Gros (2011), e cila duke folur rreth kujtesës së lexuesit dhe relativitetit të referencave që kanë rrezikun të humben me faktorin kohë, me një referim në Majkl Rifater-in, thekson se interteksti përfaqëson një mjet që dallon lexuesit e ditur, të cilët do ta njohin intertekstin dhe lexuesve të rëndomtë të cilët ndoshta nuk do ta dallojnë praninë e *sinjaleve intertekstuale*.

Modelet e aluzioneve në letërsinë shqiptare për fëmijë, gjerësisht janë të përhapura. Burimet kryesore të letërsisë për fëmijë janë nga folklori dhe nëse krijimi letrar dedikohet dhe përshtatet për moshën më të mëdha, atëherë kemi të bëjmë me lexues të ditur, që sinjalet negative do t’i kthejë në pozitive. Kështu mundësohet që të lindë aluzioni si shembull i llojit të parë të raporteve, ekskluzionit.

Aluzionet realizohen përmes formulave të hyrjes, shprehjeve, formulave të ndërtimit, etj. Kësisoj, citatet e këtilla do të jenë intrasemiotike dhe shpeshherë të pjesërishme. Këtë e gjejmë të realizuar edhe te krijimet “Verorja”, “Lugjet e Verdha”, të Rexhep Hoxhës, ku raporti me përrallën është aluzion i hapur.

Shembujt e rikrijimeve të Odhise Grillos, të cilët janë një pjesë e madhe e krijimtarisë së tij, janë vepra për të cilat vetë autori deklarohet lidhur me punën që bën (Bishqemi, 2008). Këtu raporti zakonisht është i llojit të dytë, inkluzionit, ku teksti i Grillos është teksti kornizë i cili brenda vetes përmban tekstin e tjetrit, me sinjalizim të gatshëm pozitiv dhe me qëndrim afirmativ.

“Trimëresha e Tërbaçit” gjithashtu është shembull i llojit të tretë, reminishencës, ku sipërfaqet janë në prerje. Vetë Odhise Grillo (Bishqemi, 2008), pohon që i ka bërë përshtypje kënga e Miro Tërbaçes. Ne e klasifikojmë si shembull i llojit të prerjes sepse Odhise Grillo bën mjaft ndërhyrje. Citatshmëria realizohet me përfitim të sinjaleve pozitive përmes titullit. Edhe këtu përputhjet janë të pjesërishme dhe intrasemiotike.

Në rrëfimin “Kthimi i përrallës” të shkrimtarit Rifat Kukaj, hasim një shembull të këtillë: “-Gjysh më vizato përrallën *Borëbardha dhe shtatë shkurtabiqët*”. Shembulli, teksti, hap mundësinë e konstatimit se këtu citimi është i sinjalizuar, i jashtëm, me thonjëza vetëm në pjesën e titullit, pa u rrëfyer përralla. Sipas përputhjes së materialit të parë dhe të dytë duhet theksuar se përputhja është e pjesërishme dhe kuptohet që mbetet në raportin *intrasemiotik*.

Duke konstatuar se në letërsinë shqiptare për fëmijë nuk mungojnë shembuj nga llojet kryesore të citimeve, po japim një shembull tjetër. Në veprën “Kalamajtë e pallatit tim” të Bedri Dedjës, në kreun e njëzetedytë, brenda tekstit të autorit është vendosur një këngë. Ky është shembull i pranisë së citatit të rrejtshëm/zbrazët:

“Për asqerët fëmijët këndonin dhe një këngë: Erdhi asqeri deri në përrua
Për të marrë një kokërr ftua
Ju kujtua djalli i zi
Dhe ja mbathi në shtëpi...”

Sinjalizimin e hapur e mundëson diferencimi grafik i tekstit. Shembuj të këtillë në letërsi kryesisht jepen përmes inkuadrimit të letrave, leximit të faqeve të librave dhe ngjashëm. Në raste të tilla, fjala është për dukurinë e pranisë së tekstit në tekst dhe lehtësisht konstatohen teksti kornizë dhe teksti brenda tij.

Shembull i qartë i citatit të jashtëm, intersemiotik, të zbrazët (të rrejtshëm) të “Kalamajtë e pallatit tim”, gjendet edhe në fund të kreut të katërmbëdhjetë, brenda tekstit të romanit. Në të, jepet ilustrim nga fletë e regjistratit të klasës. Gjithashtu, të njëjtin rol e luan edhe procesverbali i futur në tekst të kreu i njëmbëdhjetë.

Fillimet e letërsisë shqiptare, mund të thuhet se me përkthimet fetare kryesisht japin mundësinë e klasifikimit në citate intersemiotike. Citatet janë të shenjëzuara në sistemin e jashtëm dhe i takojnë modelit të llojit të katërt. Në këtë lloj, ku sipërfaqet përputheshin krejtësisht, përfshihen zakonisht përkthimet.

Përfundime

Pavarësisht se teoria e citatshmërisë, është fare pak e zbatuar në shembuj të letërsisë për fëmijë, punimi u mundua të tregojë se analiza e kësaj natyre jep rezultate të frytshme. Të vetëdijshëm se kjo pasqyrë e llojeve të citateve në letërsinë për fëmijë është modeste, po përmbledhim atë që nxjerr në pah punimi. Letërsia për fëmijë, në tërë trajektoren e saj dëshmon se teksti krijohet nga brum paraprak. Duke u mbështetur në mënyrat se si trajtohet ai material, kujtesa, marrjet e rimarrjet, herë të vetëdijshme e herë të rastësishme, rezultoi që gjetëm modele që i shpërndamë në katër llojet kryesore.

D.m.th. u gjetën citate intrasemiotike, intersemiotike, lloje të ekskluzionit, inkluzionit, lloje të prerjeve dhe përputhjeve. Për nga sasia e përputhjes, pamë që kishte përputhje të plota dhe të pjesërishtme. Gjithashtu, kishte modele të citateve të zbrazëta dhe sinjalizime shpeshherë të larta.

Ajo që mbetet ose hapet si ide nga ky punim, është që në të ardhmen të fokusohemi në studime të cilat do të nisen ta hulumtojnë këtë dukuri, duke u nisur nga e veçanta. Rezultate të mira dhe interesante do të kishin mundur të dalin në sipërfaqe nga krijime të periudhave të ndryshme letrare, që nga Rilindja e deri në bashkëkohësi.

Bibliografia

- Bishqemi. A. 1997. *Letërsia për fëmijë, Pjesa I-Teoria*. Universiteti "A.Xhuvani", Elbasan.
- Bishqemi. A. 2008. *Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë*. Sejko, Elbasan. f.609-610.
- Dedja. B. 2002. *Kalamajtë e pallatit tim*. Logos A, Shkup, f.109.
- Oraic-Tolic. D. 1990. *Teorija citatnosti*. GYH, Zagreb, f.13-17.
- Piegay-Gros. N. 2011. *Poetika e intertekstualitetit*. Parnas, Prishtinë, f. 28.
- Eko.U. 2007. *Për letërsinë*. Dituria, Tiranë, f.132.